



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6181 prot

Roskovec, më 17.07 2025

VENDIM

Nr. 37, datë 16.07 2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54, shkronja "k", Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë" i ndryshuar, me Ligjin Nr.24/2025, VKM-së Nr.692 datë 26.10.2022 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e "Planit Lokal të Veprimit për Rininë 2025-2027" sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturore, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.





PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË

2025-2027

BASHKIA ROSKOVEC



PËRMBAJTJA

I. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	
1.1 Qëllimi.....	5
1.2 Metodologjia.....	5
1.3 Parimet Udhëheqëse.....	7
II. BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE.....	8
III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI.....	10
IV. ANALIZA SWOT.....	16
V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	17



Përmbledhje Ekzekutive

Bashkia Roskovec, në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim Komunitar “SOT PËR TË ARDHMEN,” ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Rininë 2025-2027. Ky dokument përbën një angazhim të drejtëpërdrejtë dhe një hap të rëndësishëm në përpjekjen për të ofruar mundësi dhe zgjidhje të qëndrueshme për të rinjtë e qytetit të Roskovecit. Përmes këtij dokumenti, Bashkia Roskovec prezanton përpjekjen e saj më serioze për të ndërhyrë thellësisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse në transformimin e realitetit ku jetojnë, studiojnë dhe ëndërrojnë të rinjtë.

Ky plan është një mundësi për të krijuar një mjedis që mbështet rritjen e rinisë dhe zhvillimin e potencialeve të saj, duke i mundësuar atyre të kontribuojnë në mënyrë aktive në zhvillimin dhe mirëqenien e qytetit dhe shoqërisë në tërësi.

Vizioni ynë për vitet e ardhshme është të krijojmë kushte të favorshme për një mjedis të sigurt social, shëndetësor dhe politik, ku rinia mund të zhvillohet, të jetë aktive dhe e barabartë në të gjitha fushat e jetës. Ky vizion përfshin një të ardhme ku të rinjtë kanë mundësi të barabarta për të arritur potencialin e tyre dhe për të kontribuar në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë.

Në kuadër të këtij vizioni, prioriteti ynë është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së rinisë dhe forcimi i statusit të tyre në shoqëri. Kjo do të arrihet përmes zhvillimit të mundësive të reja dhe të qëndrueshme në fushat kyçe si arsimi, punësimi, shëndetësia, kultura dhe rritja e pjesëmarrjes aktive të rinisë në shoqëri dhe në vendimmarrje. Ky plan është hartuar në përputhje të plotë me “Strategjinë Europiane për të Rinjtë 2019-2027,” “Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029,” “Plani Social 2024- 2026” e të tjerë dokumente strategjike që synojnë të adresojë nevojat dhe sfidat që hasin të rinjtë në qytetin tonë dhe duke u siguruar që ky dokument të jetë një hap përpara drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të sigurt për të rinjtë.

Plani fokusohet në këto prioritete kryesore

1. Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës:

Ky prioritet adreson mangësitë fizike dhe materiale që mund të pengojnë të rinjtë të kenë akses në institucione edukative, përfshirë ato me aftësi të kufizuara, apo të rinjtë që përkasin grupeve vulnerabël ose të marginalizuara. Plani fokusohet në përmirësimin e kushteve të arsimit në të gjitha nivelet në territorin e Bashkisë Roskovec, duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë, pa asnjë diskriminim. Objektivat dhe masat për këtë prioritet janë ndërtuar duke marrë në konsideratë mundësitë ekzistuese për zgjidhjen e këtyre problematikave dhe duke parashtruar hapa konkretë për adresimin e nevojave të identifikuara.

2. Punësimi dhe sipërmarrja rinore:

Ky prioritet përfshin adresimin e papunësisë rinore, veçanërisht angazhimet sezonale dhe studentore, dhe përmirësimin e mundësive për punësim të qëndrueshëm dhe të denjë. Plani synon gjithashtu përmirësimin e efikasitetit të politikave të punësimit rinor dhe promovimin e mundësive për sipërmarrje dhe iniciativë rinore. Rinia do të mbështetet në angazhimin e saj

në organizata të shoqërisë civile, si dhe në partneritete me organizata ndërkombëtare dhe struktura të tjera që mundësojnë mundësi punësimi dhe zhvillimi për ta.

3. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimmarrje:

Ky prioritet synon të rrisë përfshirjen aktive të të rinjve në proceset politike dhe vendimmarrëse në nivel lokal. Plan i propozon krijimin e mundësive për të rinjtë që të përfaqësohen në Këshillin Bashkiak dhe në struktura të tjera vendimmarrëse, duke i dhënë mundësi që të kontribuojnë drejtpërdrejt në politikëbërje dhe në proceset që prekin jetën e tyre. Ky përfshirje do të mbështetet nga masa që do të rrisin motivimin dhe mundësitë për të rinjtë që të angazhohen në politikë dhe vendimmarrje në Bashkinë Roskovec.

4. Art, sport, kulturë dhe mjedisi:

Ky prioritet përfshin zhvillimin e mundësive për rininë që të angazhohen në aktivitete kulturore, artistike dhe sportive. Plan i fokusohet në krijimin e hapësirave të përshtatshme dhe mundësive për zhvillimin e talenteve rinore dhe për promovimin e aktiviteteve argëtuese dhe krijuese. Ky aspekt gjithashtu nxit zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e mjedisit të shëndetshëm, me ajër të pastër dhe hapësira të sigurta për aktivitetet fizike dhe kulturore. Aktivitetet kulturore dhe sportive do të mbështeten në mënyrë të veçantë për të nxitur kreativitetin dhe për të promovuar një shoqëri të angazhuar dhe të shëndetshme.

5. Mbështetje për organizatat rinore:

Bashkia Roskovec angazhohet të mbështesë organizatat rinore dhe nismat që i drejtohen të rinjve. Ky plan do të sigurojë financim dhe mbështetje logjistike për të mundësuar që këto organizata të funksionojnë me qëndrueshmëri dhe efektivitet, duke mundësuar realizimin e aktiviteteve që janë të dobishme për rininë. Ky mbështetje përfshin krijimin e mundësive për të rinjtë që të drejtojnë nisma dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qytetit nëpërmjet aktiviteteve rinore.

6. Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë:

Ky prioritet përfshin krijimin e një sërë shërbimesh sociale dhe shëndetësore që janë të dedikuara për të rinjtë. Këto shërbime do të adresojnë nevojat e rinisë për mbështetje shëndetësore, sociale dhe psikologjike, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Realizimi i këtyre shërbimeve do të përmirësojë mirëqenien e rinisë dhe do të sigurojë që ata të jenë të gatshëm të kontribuojnë në shoqërinë e Bashkisë Roskovec si qytetarë të përgjegjshëm dhe aktivë. Ky plan është një angazhim i rëndësishëm i Bashkisë Roskovec për të siguruar mundësi më të mira për të rinjtë dhe për të krijuar një të ardhme më të mirë dhe të qëndrueshme për ata, në harmoni me zhvillimin e qytetit dhe shoqërisë në përgjithësi.

1.1 QËLLIMI

Zhvillimet politikebërëse në Shqipëri po orientohen gjithnjë e më shumë drejt hartimit dhe zbatimit të politikave në nivel vendor, kjo në vazhden e decentralizimit të pushtetit qendror dhe mbështetjes së autonomisë së Njësisë të Qeverisjes Vendore (NjQV) për përmbushjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.

Politikat dhe dokumentat strategjike sektoriale janë instrumenta të nevojshëm për të udhëhequr sektorë të veçantë, në përputhje të plotë me funksionet dhe kuadrin ligjor. Qëllimi i këtij Plani Veprimi është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxisë zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti, pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socioekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve europiane në qeverisje.

Plani Lokal i Veprimit për Rininë frymëzohet nga vizioni evropian mbi angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve në Bashkinë Roskovec. Përparësitë e angazhimit strategjik synojnë shfrytëzimin optimal të burimeve në dispozicion dhe një bashkërendim të punës jo vetëm ndërmjet strukturave të Bashkisë Roskovec që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë por edhe bashkërendimin e punës së institucioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në fokus do të jetë dhe krijimi i sinergjive nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve.

Strategjia synon që të nxisë aktivizmin rinor dhe rritjen e kapaciteteve për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi dhe hapësira në të ardhmen. Bazuar gjithashtu në qëllimin dhe objektivat e “Strategjisë Europiane për të Rinjtë 2019-2027”, strategjia vendore për të rinjtë synon që të bashkojë të rinjtë për ndërtimin e një qyteti pa barriera, duke e kthyer kështu qytetin në një hapësirë të dedikuar për brezat e rinj.

Plani sjell në qendër nevojën për fuqizim të të rinjve për t’u angazhuar në mënyrë aktive në çështjet qytetare dhe për të zhvilluar aftësi udhëheqëse siguron një strukturë të qeverisjes vendore pjesëmarrëse dhe të fuqishme. Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Roskovec përpiqet të krijojë një mjedis që ushqen potencialin e të rinjve, duke u mundësuar atyre të bëhen kontribues aktivë në progresin dhe qëndrueshmërinë e Bashkisë Roskovec.

1.2 METODOLOGJIA

Hartimi i një plani gjithëpërfshirës lokal për të rinjtë në Bashkinë Roskovec është realizuar duke u bazuar në një metodologji të qartë, gjithëpërfshirëse dhe të mbështetur në të dhëna. Ky plan synon jo vetëm të adresojë nevojat dhe kërkesat urgjente të rinisë, por gjithashtu të

vendosë bazat për zhvillim të qëndrueshëm dhe për një ndikim pozitiv të rinisë në komunitetin e Roskovecit.

Metodologjia e ndjekur për hartimin e Plan Veprimit konsiston në 5 etapa të ndryshme. Ky Plan Veprimi është realizuar me përfshirje të gjerë të vetë të rinjve si dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm, të cilët kanë të bëjnë me realizimin e 5 prioriteteve të identifikuar. Për të arritur në rezultatet e këtij Plan Veprimi është aplikuar një metodologji mikse, ku përfshihen rishikim literature përsa i përket modeleve të suksesshme të plan veprimeve të ngjashme, intervista gjysmë të strukturuar dhe takime me aktorët kyç. Këto etapa janë zhvilluar në rend kronologjik, pasi etapa pararendëse është kusht përmbushës për atë që pason.

i. Përfshirja e palëve të interesuara

Procesi i hartimit të Planit Lokal për Rininë ka filluar me një angazhim të gjerë të palëve të interesuara. Ky hap është thelbësor për të siguruar që plani të jetë gjithëpërfshirës dhe të reflektojë nevojat reale të rinisë dhe të komunitetit në përgjithësi. Për të arritur këtë, është bashkëpunuar ngushtësisht me aktorët kryesorë të komunitetit, përfshirë drejtues së të Bashkisë, përfaqësues të rinisë dhe Këshilli Rinor Vendor, mësues, shërbime shëndetësore, qendra kulturore dhe aktorë të tjerë që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin dhe mirëqenien e rinisë. Ky angazhim ka përfshirë organizimin e fokus grupeve dhe intervistave me grupe të ndryshme, ku janë mbledhur këndvështrime të ndryshme mbi nevojat, aspiratat dhe sfidat që përballen të rinjtë e qytetit të Roskovecit.

ii. Vlerësimi i nevojave

Një nga hapat kryesorë të metodologjisë është vlerësimi i thelluar i nevojave të rinisë. Ky proces ka filluar me realizimin e një raporti mbi nevojat e të rinjve nga Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen", e cila ka analizuar jetën dhe problematikat rinore në qytetin e Roskovecit, duke vlerësuar gjithashtu bashkëpunimin midis rinisë dhe administratës vendore. Ky raport ka shërbyer si baza e të dhënave dhe ka mundësuar identifikimin e mangësive, mundësive dhe sfidave që pengojnë zhvillimin e rinisë, si dhe e ka bërë të mundur krijimin e një panorame më të qartë për nevojat më urgjente dhe strategjitë që duhet të ndiqen për t'i adresuar ato.

iii. Mbledhja dhe analiza e të dhënave:

Mbledhja e të dhënave ka qenë një fazë kyçe në procesin e hartimit të Planit Lokal. Gjatë këtij procesi, është bashkëpunuar ngushtë me shërbimet sociale, zyrën e punës dhe shkollat për të mbledhur të dhëna të detajuara mbi situatën e rinisë në Roskovec. Të dhënat janë mbledhur dhe klasifikuar sipas fushave të veprimit të secilit institucion, si arsimi, punësimi, shëndetësia, kultura dhe pjesëmarrja rinore në jetën shoqërore dhe politike. Analiza e këtyre të dhënave ka ndihmuar në identifikimin e tendencave kryesore, boshllëqeve dhe fushave prioritare për ndërhyrje. Kjo ka bërë të mundur përcaktimin e fushave më kritike që kërkojnë

vëmendje dhe veprim të menjëhershëm, si dhe kanë mundësuar ndërtimin e një plani të qëndrueshëm për adresimin e këtyre nevojave.

iv. Konsolidimi i Informacionit dhe Formulimi i Objektivave:

Pas mbledhjes dhe analizës së të dhënave, informacioni i grumbulluar është konsoliduar dhe është përdorur për të formuluar objektiva të qarta dhe të matshme për zhvillimin e rinisë. Ky proces ka përfshirë identifikimin e mundësive të reja dhe bashkërendimin e aktiviteteve midis institucioneve të ndryshme të Bashkisë Roskovec dhe aktorëve të tjerë relevantë në nivel vendor dhe rajonal. Objektivat kanë qenë të orientuara drejt krijimit të mundësive të reja për rininë, përmirësimin e kushteve të jetesës, rritjen e mundësive për arsim dhe punësim, dhe nxitjen e pjesëmarrjes rinore në jetën publike.

v. Vlerësimi i Sfidave dhe Rreziqeve

Pjesë e metodologjisë ka qenë edhe një vlerësim i mundshëm i sfidave dhe rreziqeve që mund të pengojnë zbatimin e planit. Kjo ka përfshirë shqyrtimin e mundësisë për mungesë burimesh financiare, vështirësitë në bashkëpunimin ndër-institucional dhe të tjera. Pavarësisht këtyre sfidave, planifikimi ka marrë parasysh krijimin e strategjive të menaxhimit të këtyre rreziqeve, duke garantuar që masat dhe aktivitetet të jenë të qëndrueshme dhe të mund të implementohen me sukses.

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit Lokal për Rininë është një proces i thellë, gjithëpërfshirës dhe i bazuar në të dhëna konkrete. Kjo metodologji ka siguruar që plani të jetë realist, efektiv dhe të adresojë nevojat më urgjente të rinisë, duke vendosur gjithashtu bazat për zhvillim të qëndrueshëm. Bashkia Roskovec është angazhuar për të krijuar një mjedis që mbështet zhvillimin e rinisë dhe mundëson që ata të luajnë një rol aktiv në transformimin e qytetit, duke kontribuar kështu në përparimin e përgjithshëm të shoqërisë.

1.3 PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet të cilat kanë udhëhequr procesin e hartimit të PLR-së, janë edhe parimet mbi të cilat Bashkia Roskovec synon të ndërtojë të ardhmen e qytetit me qytetarët. Më konkretisht këto parime konsistojnë në:

Zhvillimi i qëndrueshëm: Ky parim ka udhëhequr gjithë procesin e hartimit të PLVR-së dhe udhëheq njëherazi gjithë strategjitë kryesore kombëtare, rajonale dhe vendore. Pra është e rëndësishme që shfrytëzimi i burimeve të bëhet në mënyrë sa më të balancuar dhe nëpërmjet një planifikimi të integruar për të arritur zhvillim ekonomik dhe social që garanton qëndrueshmëri në kohë dhe jetëgjatësi. Ky parim është thelbësor kur flitet për të ardhmen e rinisë, motorrit kryesor të shoqërisë shqiptare.

Subsidiariteti: Strategjia është hartuar duke pasur parasysh që ushtrimi i përgjegjësiive publike duhet në mënyrë të përgjithshme, t'iu takojë më tepër autoriteteve të cilat janë më pranë qytetarëve ku dhe impakti është më i madh. Bashkia Roskovec që prej vitit 2015 ka

pašur në fokus të veçantë rininë nisur edhe nga fakti se zhvillimi dhe integrimi i të rinjve është cilësuar gjithmonë si guri i themelit të një shoqërie të fortë.

Bashkërendimi: Kjo strategji ka synuar të koordinohet me kuadrin strategjik të zhvillimit të Bashkisë Roskovec, duke ndjekur objektivat dhe parimet thelbësore të zhvillimit të përcaktuara në dokumentat strategjike vendore. Në të njëjtën mënyrë, PLR është përpjekur të jetë në harmoni me interesat e shoqërisë civile dhe organizimeve rinore duke promovuar forma të ndryshme bashkëqeverisjeje apo bashkëpunimi për një zhvillim të qëndrueshëm. Përpjekjet e organizuara të të gjithë niveleve qeverisëse të mbështetura edhe nga organizatat rinore do të fuqizojnë rolin e të rinjve në të gjitha fushat.

Llogaridhënia dhe Transparenca: Qëllimet dhe objektivat strategjike, të përcaktuara në këtë strategji janë përkthyer në projekte dhe aktivitete specifike të matshme nëpërmjet treguesve të performancës, duke i bërë këto objektiva lehtësisht të matshme dhe të monitorueshme.

Gjithëpërfshirja: Strategjia ka patur në fokus kryesor filozofinë e gjithëpërfshirjes sociale duke u përpjekur në trajtimin e problematikave kryesore të çdo grupi social, me një vëmendje të lartë ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Kjo nënkupton, krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë të rinjtë e Bashkisë Roskovec duke i ndihmuar ata në arritjen e mirëqënies së përbashkët.

Fleksibiliteti: Duke marrë në konsideratë reformat e shumta që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit dhe ndryshimet thelbësore që kanë prekur funksionet dhe kompetencat e NJQV-ve, strategjia është hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë hapësirat e nevojshme për t'iu përshtatur kontekstit politik ende në ndryshim e sipër. Kjo do të thotë se objektivat strategjike dhe projektet janë hartuar duke marrë parasysh disa skenarë zhvillimi për të arritur përmbushjen më optimale të tyre përgjatë kësaj periudhe tranzicioni.

II. BASHKËRENDIMI ME LEGJISLACIONIN DHE POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE

Vizioni i këtij dokumenti orientues e strategjik për tre vitet e ardhshme kërkon vendosjen e rinisë në fokus të jetës aktive të qytetit nëpërmjet mbështetjes së partneritetit dhe nxitjes së bashkëpunimit me të rinjtë e vendeve Europiane. Në mënyrë që të realizohet ky vizion afat-mesëm, është parësore që të bashkërendohet me planet kombëtare afat-mesme dhe afat-gjata dhe të ketë koordinim më efikas me organizatat rinore dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces. Mungesa për një kohë të gjatë e kuadrit ligjor për rininë ka bërë që përfshirja e të rinjve në jetën publike, vendimmarrje politike dhe shërbimet e dedikuara për rininë të jenë në vullnetin e titullarëve të institucioneve publike.

Mungesa e kuadrit ligjor ka bërë që edhe bashkëpunimi jo vetëm ndërinstitutional por ndërmjet rrjetit të shoqërisë civile dhe organizatave rinore të jetë i pastruktuar dhe nuk përfshin të gjitha aspektet ku përfshihet rinia. Prandaj gjatë procesit të hartimit të Planin Lokal të Veprimit të Rinisë 2025-2027 janë marrë në konsideratë objektivat e politikave dhe

planeve kombëtare, rajonale dhe vendore për të krijuar një kuadër zhvillimor më koherent dhe të qëndrueshëm dhe sa më pranë standardeve të Bashkimit European (BE).

Në nivel ndërkombëtar:

Strategjia e BE-së për Rininë 2017-2029 e cila advokon fuqishëm për “punën e të rinjve” një koncept holistik që shkon përtej punësimit dhe mbulon aspekte të ndryshme të zhvillimit personal të të rinjve. Siç është përcaktuar në Strategjinë e Rinisë të BE-së, ka të bëjë me “fuqizimin, emancipimin, përgjegjësinë dhe tolerancën...”.

Strategjia e Mbrojtjes Sociale BE 2024-2030 përcakton mekanizmat dhe strategjitë për përfshirje sociale gjatë ciklit të jetës së individëve si: fëmijët, individët në moshë pune, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar dhe komunitetet. Për më tepër, është mbështetur nga programi i Progresit, një instrument financiar që ka për qëllim zhvillimin e politikave në 5 fusha strategjike: punësimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale, kushtet e punës, anti-diskriminimi dhe barazia gjinore.

Në nivel kombëtar:

Programi i Qeverisë 2021-2025, Ky program në seksionin e rinisë, parashikon hartimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, programe dhe projekte për nxitjen e punësimit, forcimin e një kuadri ligjor të qartë për rininë ku përcaktohen qartë kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes lidhur me përgjegjësitë që kanë ndaj të rinjve, si dhe forcimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 (SKZHI) përcakton një qasje të integruar për zhvillimin socio-ekonomik të vendit po ashtu dhe për integrimin në BE. Është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritetit evropian.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 ka qëllim ndërtimin e një fuqie punëtore më të arsimuar dhe të aftë sipas nevojave të tregut të punës. Politikat prioritare të identifikuar janë: a) forcimi i mundësive të punësimit përmes politikave efektive të tregut të punës, ku ofrimi i sa më shumë mundësive për të rinjtë është një prioritet; b) ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor dhe trajnimit të të rinjve dhe të rriturve; c) nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial; dhe d) forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 mundëson për ndërtimin e një sistemi të mbrojtjes sociale ku individët fuqizohen dhe grupeve vulnerabël iu ofrohen oportunitete që i bëjnë ata më shumë autonomë shoqëruar kjo me mekanizmat parandalues dhe të ri-integritetit në shoqëri.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2022-2029 është dokumenti ku bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e

politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm.

Në nivel vendor:

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal 2020-204 - Plani Operacional i Zhvillimi Lokal (POZHL) është një instrument planifikimi për Bashkinë Roskovec dhe pjesë integrale e zbatimit të Reformës Territoriale-Administrative, si dhe planifikimit të zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor dhe urban që do të kryhet në të ardhmen.

Plan Lokal Veprimi për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2019 – 2022 - targeton pakicat rome dhe egjiptiane dhe paraqet në mënyrë të detajuar masat që do të zbatohen në kuadër të politikave të Bashkisë Roskovec për fushat prioritare të planit. Ky plan është hartuar me mbështetjen e programit ROMACTED të Këshillit të Europës dhe ka për qëllim integrimin e këtij komuniteti në pesë fusha prioritare: Arsimi, Punësimi, Strehim, Kujdesi Shëndetësor dhe Shërbimet Sociale.

Plani Social 2024- 2026 synon të zhvillojë dhe përmirësojë shërbimet e mbrojtjes dhe përkujdesit social për ti shërbyer cilësisht dhe në përputhje cdo anëtarit të komunitetit local. Ai synon të përmirësojë dhe zgjerojë nivelin e shërbimeve ekzistuese, si dhe të përfshijë në këto shërbime cdo individ që i ka të nevojshme ato.

Plani i Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023 për Bashkinë Roskovec ka për qëllim gjithëpërfshirjen dhe nxitjen e zhvillimit të rinisë të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor.

III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI

Roskoveci është një bashki e vogël në Qarkun e Fierit, në jugperëndim të Shqipërisë. Përbëhet nga zona urbane dhe rurale, ku ekonomia mbështetet kryesisht në bujqësi, biznes të vogël dhe shërbime publike të kufizuara. Bashkia ka pësuar lëvizje të moderuara të popullsisë për shkak të migracionit dhe urbanizimit, veçanërisht të popullsisë së re.

Në përputhje me ligjin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, të rinjtë konsiderohen individë në moshën 15 deri 29 vjeç. Sipas të dhënave të INSTAT dhe vlerësimeve lokale (2023), të rinjtë përbëjnë rreth 20–25% të popullsisë totale të Roskovecit, që do të thotë afërsisht 3,000–3,500 të rinj. Përbërja gjinore është e balancuar, megjithatë vajzat dhe gratë e reja përballen më shumë me kufizime në qasje në hapësira publike, punësim dhe mundësi angazhimi. Të rinjtë në qytetin e Roskovecit përballen me një sërë problematikash që janë të ngjashme me ato të rinisë në të gjithë Shqipërinë, por që merr një nuancë specifike për shkak të karakteristikave të qytetit si një zonë më e vogël dhe më pak e zhvilluar. Në këtë qytet, mundësitë për angazhimin e të rinjve janë të kufizuara dhe shpesh të pamjaftueshëm për të adresuar nevojat dhe aspiratat e rinisë. Megjithatë, një nga problematikat më të theksuara është pikërisht mundësia e kufizuar e aksesit në mundësitë që ekzistojnë, për shkak të shpërndarjes jo të barabartë të këtyre mundësive ndërmjet të rinjve në qytet dhe në njesi të

tjera administrative të Bashkisë. Shumica e të rinjve jetojnë në qytetin Roskovec, ku kanë akses më të mirë në shkolla, qendrën rinore, internet dhe hapësira rekreative. Ky problem është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në zhvillimit të rinisë dhe mund të konsiderohet si një barrierë për krijimin e mundësive për të gjithë të rinjtë e Roskovecit. Fshatrat si Kurjan, Strum, dhe Kuman kanë popullsi rinore të konsiderueshme, por me akses të kufizuar në arsimin, shërbimet shëndetësore dhe mundësi për angazhim social. Shumë të rinj zhvendosen drejt Tiranës, Fierit ose jashtë vendit për arsye arsimimi dhe punësimi. Një pjesë e konsiderueshme e maturanëve dhe studentëve emigrojnë. Kjo dukuri prek më shumë djemtë, por edhe vajzat, sidomos pas martesës. Migracioni i të rinjve po shkakton turrje dhe plakje të popullsisë në zonat rurale dhe po dobëson pjesëmarrjen rinore në zhvillimin lokal.

Shkalla e papunësisë së të rinjve Shumica e të rinjve përfundojnë arsimin fillor dhe vazhdojnë në shkollën e mesme. Aftësitë bazë janë të përhapura te të rinjtë urbanë, por mungojnë aftësitë e avancuara në teknologjitë e informacionit. Vajzat dhe gratë e reja janë më pak aktive në tregun e punës, për shkak të detyrimeve familjare dhe pritshmërive shoqërore. Të rinjtë rurale përballen me izolim social dhe gjeografik. Të rinjtë e marginalizuar, romë/egjiptianë, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata jashtë arsimit dhe punës (NEET) janë më të rrezikuar nga përjashtimi. Një shqetësim në rritje është shëndeti mendor, me akses të kufizuar në shërbime psikosociale apo informacione të përshtatshme për të rinjtë.

Një nga sfidat më të dukshme për rininë e qytetit është **pjesëmarrja e ulët në politikëbërje dhe qeverisje**. Ky fenomen, i cili është i pranishëm edhe në shumë zona të tjera, është i theksuar në Roskovec për shkak të apatisë dhe mungesës së interesit të rinisë për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe qeverisjes lokale. Pavarësisht krijimit dhe funksionimit të Këshillit Rinor Vendor në Bashkinë Roskovec, kjo mungesë angazhimi është gjithashtu e lidhur me një ndjenjë të përgjithshme të izolimit dhe të pafuqisë që ndjejnë të rinjtë, të cilët shpesh nuk e shohin politikën si një mundësi për të kontribuar në ndryshime konkrete në jetën e përditshme.

Për më tepër, **nevojat për infrastrukturë dhe aktivitete edukuese** janë shumë të theksuara. Shkollat e Roskovecit nuk kanë mundësi të ofrojnë mjedise të përshtatshme për zhvillimin e rinisë, duke përfshirë mungesën e pajisjeve të specializuara për laboratorë, dhe nevojën për përmirësimin e kurrikulave mësimore, që mund të ndihmojnë të rinjtë të jenë më të përgatitur për sfidat e tregut të punës. Këtu përfshihet gjithashtu **nevoja për krijimin e mundësive për këshillim karriere**, që mund të ofrohet përmes strukturave si shkollat dhe apo qendrat rinore. Padyshim, kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të rinisë dhe mundësitë e tyre për t'u integruar në tregun e punës.

Në këtë kuadër, një tjetër problem që vërehet në Roskovec është **mungesa e mundësive për punësim dhe orientim drejt tregut të punës**. Të rinjtë shpesh nuk kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë e nevojshme profesionale përmes kurseve profesionale, internshipeve, ose mundësive për punësim sezonal. Zhvillimi i **internshipeve dhe trajnimeve**, si dhe mundësitë për punësim në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, janë domosdoshmëri për të mundësuar që të rinjtë të përfitojnë dhe të ndihmohen të ndërtojnë një karrierë të qëndrueshme.

Një nga nevojat më emergjente që ka rinia e Roskovecit është **nxitja e mundësive për pjesëmarrje aktive rinore në politikëbërje dhe pjesëmarrja e të rinjve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak**. Në këtë aspekt, është thelbësore që të rinjtë të inkurajohen dhe të përfshihen në vendimmarrje, duke kontribuar jo vetëm në zhvillimin e politikave rinore, por edhe në forcimin e lidhjeve të tyre me qeverisjen vendore. Funksionimi i **Këshillit Rinor Vendor**, dhe përfshirja në nisma rinore mund të sigurojnë që zëri i rinisë të dëgjohet dhe të përfshihet në vendimmarrje.

Në aspektin e **pjesëmarrjes kulturore dhe sportive**, qyteti ka një mangësi të dukshme në ofrimin e hapësirave të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve kreative dhe sportive. **Krijimi i terreneve sportive, shtimi i hapësirave të gjelbëruara, dhe organizimi i shfaqjeve kulturore**, si ekspozita dhe konkurse kulturore, janë elementë që do të kontribuonin në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të mundësonin zhvillimin e talenteve të rinj. Padyshim, këto mundësi do të rrisnin gjithashtu pjesëmarrjen e rinisë në aktivitete që janë pozitive për zhvillimin e tyre personal dhe mireqënien e tyre.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është mbështetja e strukturave rinore, siç është **Qendra Sociale Komunitare**, e cila aktualisht është pika e vetme e takimit për aktivitete socio-kulturore për të rinjtë e qytetit. Megjithatë, kjo qendër ka nevojë për më shumë mbështetje dhe burime për të mundësuar një angazhim më të gjerë të rinisë në aktivitete të ndryshme zhvillimore dhe sociale. Po ashtu, struktura e **Këndit të BE-së**, që zhvillon takime dhe trajnime periodike për të rinjtë, është një mundësi e vlefshme që duhet të forcohet dhe të shfrytëzohet më shumë për të promovuar angazhimin rinor dhe për të zhvilluar kapacitetet e rinisë në fusha të ndryshme si barazia gjinore, të drejtat e njeriut, dhe sipërmarrja. **Problematikat e rinisë në Roskovec** janë të lidhura ngushtë me mungesën e mundësive të barabarta dhe të drejta për të gjithë grupimet rinore. Për të adresuar këto probleme, është e nevojshme që Bashkia Roskovec të krijojë një sistem të qartë dhe efikas që ofron mundësi për zhvillim, pjesëmarrje dhe përfshirje rinore në çdo aspekt të jetës shoqërore dhe ekonomike të qytetit. Të rinjtë në Roskovec kanë nevojë për përmirësimin e aftësive dixhitale dhe akses në teknologjitë e reja. Në një treg pune gjithnjë e më të dixhitalizuar, mungesa e edukimit teknologjik mund të përjashtojë të rinjtë nga mundësitë ekonomike dhe sociale.

PRIORITETI I. ARSIMI CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Objektiv Strategjik	Indikatorë	Nderhyrje	Financim	Afatet Kohore	Palët Përgjegjëse
OS1. Ekzistenca, qëndrueshmëria dhe menaxhimi i mjediseve multifunksionale në institucionet arsimore në Roskovec	1) Numri i bibliotekave dhe palestrave të rikonstruktura; 2) Buxheti i investuar për rikonstruktimin e palestrave dhe bibliotekave ekzistuese, si dhe hapjen e bibliotekave/ palestrave të reja në	1.1.1 Krijimi i mjediseve multifunksionale (biblioteka, palestra të reja, terrene sportive); 1.1.2 Rritja e investimeve në palestrat dhe bibliotekat ekzistuese pranë institucioneve arsimore, si dhe kujdes maksimal për	Buxheti i bashkisë Roskovec Ministria e Arsimit dhe e Sporteve Ministria e Shtetit për rininë dhe fëmijët	2026-2029	Bashkia Roskovec Ministria e Arsimit dhe e Sporteve Ministria e Shtetit për rininë dhe fëmijët

	shkollat 9-vjeçare dhe të mesme;	mirëmbajtjen e tyre; 1.1.3 Rivlerësimi për nga funksioni i hapësirave fizike ekzistuese brendashkollave 9-vjeçare, të mesme dhe institucioneve të tjera arsimore;	Fonde nga grante të huaja		
OS2. Aksesueshmëria e plotë dhe efikase e të rinjve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore	1)Infrastruktura e nevojshme për nxënësit me aftësi ndryshe në çdo shkollë 9-vjeçare dhe të mesme; 2_ Buxheti i investuar për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese për nxënësit me aftësi ndryshe në çdo shkollë 9-vjeçare dhe të mesme.	1.2.1 Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për nxënësit me aftësi ndryshe; 1.2.2 Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese, për një përdorim sa më të lehtë.	Buxheti i bashkisë Roskovec Ministria e Arsimit dhe e Sporteve Ministria e Shtetit për rininë dhe fëmijët Fonde nga grante të huaja	2026-2029	Bashkia Roskovec Ministria e Arsimit dhe e Sporteve Ministria e Shtetit për rininë dhe fëmijët
OS3. Siguria e institucioneve arsimore në qytetin e Roskovecit	1) Infrastruktura dhe sinjalistika rrugore;; - 2) Buxheti i investuar për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme mbrojtëse në shkolla.	1.2.3 Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme mbrojtëse për shkollat.	Buxheti i bashkisë Roskovec Ministria e Arsimit dhe e Sporteve Ministria e Shtetit për rininë dhe fëmijët Fonde nga grante të huaja	2026-2029	Bashkia Roskovec Ministria e Arsimit dhe e Sporteve Ministria e Shtetit për rininë dhe fëmijët

PRIORITETI II. PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE

Objektiv Strategjik	Indikatorë	Nderhyrje	Financim	Afatet Kohore	Palët Përgjegjëse
OS1. Rritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Bashkisë Roskovec, bizneseve dhe aktorëve që punësojnë në punësimin e të rinjve.	1)Lehtësirat administrative të ofruara prej bashkisë për bizneset/institucionet që punësojnë të rinj e të reja; 2) Numri i të rinjve të punësuar.	2.1.1 Lidhja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit mes bizneseve, institucioneve të ndryshme dhe Bashkisë Roskovec	Buxheti i bashkisë Roskovec Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Fonde nga grante të huaja	2025 në vazhdim	Bashkia Roskovec

OS2. Aftësimi i të rinjve për tregun e punës.	1) Numri i trajnimeve të zhvilluara për aftësimin e të rinjve në tregun e punës; 2) Numri i të rinjve të trajnuar	2.2.1 Zhvillimi i trajnimeve të ndryshme për aftësimin e të rinjve në tregun e punës.	Buxheti I bashkisë Roskovec Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Fonde nga grante të huaja	2025 në vazhdim	Bashkia Roskovec
OS3. Politika dhe programe mbështetëse për sipërmarrjet rinore dhe sipërmarrësit e rinj.	1) Numri i trajnimeve të zhvilluara për të rinjtë mbi sipërmarrjen, taksimin, etj; 2) Numri i të rinjve të trajnuar;	2.3.1 Ofrimi i trajnimeve dhe kurseve të formimit për të rinjtë mbi sipërmarrjen, taksimin, mundësitë e biznesit, procedurat vendore etj	Buxheti I bashkisë Roskovec Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Fonde nga grante të huaja	2025 në vazhdim	Bashkia Roskovec

PRIORITETI III. PJESËMARRJA DHE PËRFAQËSIMI RINOR NË VENDIMARRJE

Objektiv Strategjik	Indikatorë	Nderhyrje	Financim	Afatet Kohore	Palët Përgjegjëse
OS1. Mirëfunksionimi dhe efektiviteti i Këshillit Rinor Vendor pranë Bashkisë Roskovec në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të rinisë së qytetit	1) Njoftimet e Bordit për nismat e planifikuara; - 2) Numri i iniciativave dhe bashkëpunimeve mes KVR dhe Këshillit Bashkiak të Tiranës.	3.1.1 Mirëorganizim i KVR 3.1.2 Informimi i të rinjve mbi çdo nismë dhe hap që ndërmerr KVR 3.1.3 Ngritje urash bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë, Këshillit Bashkiak, KVR dhe të rinjve të qytetit.	Buxheti I bashkisë Roskovec	2025-2027	Bashkia Roskovec
OS2. Politikat rinore të jenë të hartuara dhe konsultuara në bashkëpunim me të rinjtë.	1) Numri i politikave rinore dhe vendimet e konsultuara me të rinjtë, organizatat dhe grupet rinore. 2) Numri i programeve motivuese për pjesëmarrjen e të rinjve në politikëbërje dhe qeverisje	3.2.1 Konsultimi i çdo politikë rinore dhe vendim për të rinjtë me çdo organizatë, apo të ri të interesuar në qytetin e Roskovecit; 3.2.2 Programe motivuese për pjesëmarrjen e të rinjve në politikëbërje dhe qeverisje; 3.2.3 Ngritja e kanaleve të komunikimit mes Këshillit Bashkiak dhe të rinjve.	Buxheti I bashkisë Roskovec	2025-2027	Bashkia Roskovec
OS3. Rritja e buxhetit për të rinjtë Bashkinë Roskovec për të adresuar dhe përmbushur nevojat dhe kërkesat e të rinjve të qytetit.	1) Numri i takimeve konsultuese për buxhetin; 2) Buxhet specifik dedikuar të rinjve 3) Numri i organizatave e të rinjve të përfshira në hartimin e buxhetit;	3.3.1 Bashkia e Roskovecit duhet të konsultohet për hartimin e Buxhetit të Rinisë me të gjitha organizatat rinore dhe të rinjtë para se të dërgohet për miratim; 3.3.2 Bashkia duhet ta	Buxheti I bashkisë Roskovec	Gjate degjesave që organizohen në kuader të PBA-se. Në fund të çdo viti përpara miratimit të buxhetit të vitit	Administrata e Bashkisë në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak

		alokojë Buxhetin e Rinisë bazuar në nevojat reale të tyre.		pasardhës.	
OS4. Rritja e bashkëpunimit mes organizatave rinore, të rinjve, Bashkisë dhe aktorëve të tjerë.	1) Numri i takimeve konsultuese, seancave dëgjimore mbi politika rinore, prioritete, problematika, si edhe çështje të ndryshme për të rinjtë që jetojnë në Bashkinë Roskovec. 2) Numri i nismave dhe porjketeve të përbashkëta	3.4.1 Krijimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizatat dhe Bashkisë,	Buxheti I bashkisë Roskovec		Bashkia Roskovec

PRIORITETI IV. MBËSHTETJA E ORGANIZATAVE DHE NISMAVE RINORE

Objektiv Strategjik	Indikatorë	Nderhyrje	Financim	Afatet Kohore	Palët Përgjegjëse
OS1. Programe dhe politika nxitëse për Mirëfunksionimin e organizatave dhe nismave rinore.	1) Numri i të rinjve të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve që organizon Bashkia Roskovec. 2) Numri i aktiviteteve rinore të organizuara në Qendrën Social Komunitare. 3) Numri i projekteve/aktiviteteve të zbatuara në bashkëpunim me OJF vendore. 4) Numri i bashkëpunimeve me OJF të tjera. 5) Marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata / grupe të ndryshme rinore. 6) Numri i shkëmbimeve rinore të realizuara me Bashki të tjera.	4.1.1 Mbeshtetja e organizatave lokale. 4.1.2 Forcimi i partneriteteve me organizata te tjera rinore në nivel lokal dhe kombëtar. 4.1.3 Nxitja e grupit aktiv të të rinjve të Qendrës Social Komunitare. 4.1.4 Rritja e shkëmbime rinore me të rinjë në Bashki të tjera. 4.1.5 Angazhimi dhe përfshirja e grupeve rinore në festat dhe aktivitete të përvitshme që organizon Bashkia Roskovec.	Grante nga donator të huaj dhe vendas	2025-2027	Bashkia Roskovec

PRIORITETI V. ARTI, SPORTI, KULTURA DHE MJEDISI

Objektiv Strategjik	Indikatorë	Nderhyrje	Financim	Afatet Kohore	Palët Përgjegjëse
OS1. Nxitja e aktiviteteve artistike, sportive, kulturore dhe mjedisore.	1) Numri i nxënësve, klasave, shkollave, personelit pjesëmarrës në kampionatet sportive. 2) Numri i aktiviteteve kulturore, artistike, sportive të mbështetura. 3) Numri i aksioneve të pastrimit të realizuara. 4) Numri i shfaqjeve, ekspozitave, takimeve letrare të zhvilluara.	5.1.1 Promovimi i talentëve në fushën e artit, sportit, kulturës. 5.1.2 Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe fushatave vendore të pastrimit. 5.1.3 Organizimi i festave tradicionale të përvitshme si Festa e Ullirit, Festa e Qytetit, etj.	Buxheti I bashkisë Roskovec Grante nga donator të huaj dhe vendas	2025-2027	Bashkia Roskovec

	5) Numri i festave të zhvilluara. 6) Numri i talenteve rinore të mbështetur financiarisht në sport.				
OS2. Krijimi, mirëfunksionimi dhe mirëmenaxhimi i hapësirave dhe mundësive që të rinjtë të ushtrojnë art, kulturë, sporte dhe forma të tjera rekreative.	1) Numri I aktiviteteve të reliazuara 2) Numri I klubeve artistike	5.2.1 Organizimi i shfaqjeve, ekspozitave, takimeve letrare/kulturore, panaire. 5.2.2 Krijimi I klubeve të ndryshme, letrare, artistike etj.	Buxheti I bashkisë Roskovec Grante nga donator të huaj dhe vendas	2025-2027	Bashkia Roskovec
OS3. Rritja e hapësirave rekreative dhe publike për të rinjtë e Tiranë	1) Numri I hapësirave rekreative	5.3.1 Rijetëzimi i hapësirave publike. 5.3.2 Buxheti i vendosur në dispozicion për ndërtimin rijetëzimin e hapësirave publike.	Buxheti I bashkisë Roskovec Grante nga donator të huaj dhe vendas	2027	Bashkia Roskovec

PRIORITETI VI. ÇËSHTJET SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE SHËRBITIMET PUBLIK

Objektiv Strategjik	Indikatorë	Nderhyrje	Financim	Afatet Kohore	Palët Përgjegjëse
OS1. Ngritja dhe përmirësimi i shërbimeve të përkujdesit social dhe shoqërore për të rinjtë dhe kategori në nevojë.	1) Numri i përfutësve të shërbimit shëndetësor 24 orë. 2) Numri i përfutësve të kujdesit ditor të qendrës PAK. 3) Numri i përfutësve të shërbimeve të zyrës më një ndalesë. 4) Dokumenta të tjerë mbështetës për zbatimin e projekteve rehabilituese. 5) Numri i aktiviteteve rinore të zhvilluara në Qendrën Social Komunitare. 6) Numri i personelit të shtuar të QSK dhe kurset e zhvilluara.	6.1.1 Rikonstruktimi i qendrës shëndetësore 24 orëshe. 6.1.2 Rehabilitimi dhe ngritja e këndeve shlodhëse dhe argëtuese midis lagjeve. 6.1.3 Zhvillimi i përhershëm i aktiviteteve rinore në Qendrën Social Komunitare dhe pajisja e saj me mjete për klasat/kurst e ndryshme.	Buxheti I bashkisë Roskovec Grante nga donator të huaj dhe vendas Ministria e shëndetësisë dhe çështjeve Sociale	2027	Bashkia Roskovec Ministria e shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OS2. Garantimi i aksesit të të rinjve në: Informim; Ndërgjegjësim dhe Shërbime të ndryshme, të cilat ofrohen nga Bashkia e Roskovecit.	1) Numri i takimeve, nismave, fushatave të ndryshme informuese nga Bashkia për çështjet shëndetësore, sociale, si dhe shërbimet publike; 2) Numri I programeve, shërbimeve	6.2.1 Rritja e ofritit të shërbimeve psikosociale, për të rinjtë e Roskovecit referuar nevojave të këtyre të fundit; 6.2.2 Krijimi i programeve vullnetare, Bashkia Roskovec si ofruese e shërbimeve vullnetare	Buxheti I bashkisë Roskovec Grante nga donator të huaj dhe vendas Ministria e shëndetësisë	2026-2027	Bashkia Roskovec Ministria e shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

			dhe çështjeve Sociale		
PRIORITETI VII: PROMOVIMI I INOVACIONIT DHE RITJIA E AFTËSIVE DIXHITALE TEK TË RINJTË					
OS 1: Të rriten aftësitë teknologjike të të rinjve në Roskovec	- Numri i të rinjve të trajnuar në teknologji - Pjesëmarrja në aktivitete teknologjike - Krijimi i klubeve të teknologjisë	- Trajnime për TIK, kodim dhe siguri kibernetike në shkolla dhe qendra rinore - i një Laboratori Dixhital në qendrën rinore - Organizimi i një "Java e Teknologjisë" me gara dhe ekspozita	Buxheti i bashkisë Partnerë zhvillimi Donatorë lokalë ose privatë (ISP, banka)	2025 – 2027	Bashkia Roskovec Drejtoritë Arsimore Qendra Rinore Organizata të TIK-ut Shkollat e mesme
OS 2: Të nxisim ndërmarrësinë dixhitale tek të rinjtë e zonave urbane dhe rurale	- Numri i të rinjve që marrin pjesë në kurse sipërmarrjeje - Projekte pilot/start-up të krijuara nga të rinjtë - Rritja e bashkëpunimit me sektorin privat	- Trajnime për zhvillimin e ideve të biznesit dhe përdorimin e teknologjisë - Hapja e inkubatorëve të ideve në bashkëpunim me universitetet ose qendrat e inovacionit - Përfshirja e sektorit privat në mentorim	Projekte me financim të jashtëm Fondet e bashkisë Donatorë ndërkombëtarë	2025 – 2028	Bashkia Roskovec Qendra Rinore Universitete partnere Dhoma e Tregtisë Startup-e dhe mentorë lokalë
PRIORITETI VIII: PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I VAJZAVE DHE GRAVE TË REJA					
OS1. Të rritet pjesëmarrja e vajzave dhe grave të reja në jetën publike, sociale dhe ekonomike	- Numri i aktiviteteve mbi barazinë gjinore - Rritja e pjesëmarrjes së vajzave në forume rinore dhe vendimmarrje - Përfshirja e djemve në temat mbi barazinë dhe dhunën me bazë gjinore	- Fushata ndërgjegjësuere në shkolla dhe komunitet - Trajnime për liderizëm për vajza - Klube të barazisë gjinore dhe debate me pjesëmarrje të vajzave dhe djemve - Ngritja e një mekanizmi rinor për raportimin e diskriminimit	Buxheti i bashkisë Donatorë dhe organizata si UN Women, UNDP, EU etj.	2025 – 2027	Bashkia Roskovec Qendra Rinore Shkollat Organizata të shoqërisë civile UN Women, UNDP, EU etj.

IV. ANALIZA SËOT

Analiza SËOT është një metodë planifikimi e strukturuar që përdoret gjerësisht për të evidentuar dhe vlerësuar Pikat e Forta (Strengths), Pikat e Dobëta (Weaknesses), Mundësitë (Opportunities) dhe Rreziqet/ Sfidat (Threats) të një projekti, çështjeje, territori, etj. Gjatë hartimit të këtij Plani Veprimi, kjo metodë u përzgjedh si një instrument mjaft praktik dhe i dobishëm për të analizuar situatën ekzistuese, analizë mbi bazën e të cilës u hartuan qëllimet dhe objektivat strategjike.

Pikat e dobëta dhe Pikat e forta evidentojnë çështje shqetësuese të të rinjve brenda territorit të Bashkisë Roskovec, të cilat mund të adresohen nëpërmjet politikave vendore, ndërsa Mundësitë dhe Sfidat i përkasin aspekteve të jashtme, kontrolli i të cilave mund të kërkojë bashkëpunim ndërvendor apo angazhim të qeverisë vendore e më gjerë.

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
----------------------	-----------------------

✚ Përqindje e lartë e popullsisë së re – Potencial i rëndësishëm për zhvillim afatgjatë. ✚ Institucione arsimore aktive (shkolla 9-vjeçare dhe të mesme) që mund të angazhohen në aktivitete informuese, kulturore dhe sociale. ✚ Qendër Rinore funksionale që shërben si hapësirë për zhvillim kapacitetesh. ✚ Përkushtim politik i bashkisë për të përfshirë të rinjtë në politika vendimmarrëse dhe aktivitete komunitare. Pjesëmarrja e të rinjve në veprimtari artistike dhe kulturore ✚ Aktivitete sportive dhe edukative ✚ Mbështetja e programeve start-up ✚ Përkrahja e talentëve të reja ✚ Përkrahja e grupeve vulnerabël ✚ Angazhimi i të rinjve në shërbime komunitare ✚ Pjesëmarrja e të rinjve në programet e kujdesit social	✚ Mungesa e kuadrit ligjor ✚ Mungesa e organizatave rinore lokale ✚ Pamjaftueshëria e informacionit në lidhje me sportin dhe kujdesin për shëndetin, SST, drogën, alkoolin ✚ Mungesa e kurrikulave arsimore për nxitjen e aktivizmit rinor ✚ Pamjaftueshëria e infrastrukturës arsimore në fshatrat përreth ✚ Migrimi i të rinjve, veçanërisht pas përfundimit të shkollës së mesme. ✚ Mungesë alternativash për punësim dhe praktikë profesionale, sidomos për vajzat dhe të rinjtë në zonat rurale. ✚ Pjesëmarrje e ulët në vendimmarrje dhe mungesë strukturash formale për përfaqësim rinor. ✚ Mungesë hapësirash dhe aktiviteteve të rregullta kulturore, sportive, teknologjike, që kufizojnë zhvillimin social. ✚ Ndikim i ulët i digjitalizimit dhe përdorim i paktë i teknologjisë për inovacion dhe sipërmarrje.
MUNDËSITË	KËRCENIMET
✚ Trajnime për aftësitë në biznes për të rinjtë ✚ Konkurse për talente të ndryshme për të rinjtë ✚ Mbështetje me orientime profesionale dhe kualifikime ✚ Nxitja e vullnetarizmit ✚ Edukimi mjedisor ✚ Nxitja e punësimit për të rinjtë e komuniteteve të disavantazhuara ✚ Interes i vazhdueshëm nga investitorë ✚ Thithja e fondeve ndërkombëtare ✚ Bashkëpunim me organizatat rinore kombëtare/bashkive të et.j	✚ Buxhet i kufizuar ✚ Pjesëmarrje e pamjaftueshme e të rinjve në vendim marrje ✚ Procedurat burokratike ✚ Mungesa e sistemit për sigurimin e mbrojtjes sociale të të rinjve ✚ Fenomeni i pasivitetit qytetar tek të rinjtë, veçanërisht për temat si barazia gjinore, përfshirja sociale, siguria kibernetike. ✚ Bashkëpunimi të vazhdueshëm ndërinstitucional për zgjidhjen e çështjeve të rinisë.

Interes në rritje për fushat e teknologjisë dhe inovacionit mes të rinjve.	
---	--

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi është një aktivitet i vazhdueshëm dhe i strukturuar, i cili përfshin mbledhjen e të dhënave dhe informacionit të nevojshëm për matjen e indikatorëve të përcaktuar. Ai është një mjet esencial për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po implementohen siç është parashikuar dhe, po ashtu, për të mbledhur informacion të vlefshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të lindin gjatë zbatimit të planit. Ky proces është jetik për sigurinë e një zbatimi të suksesshëm të **Planit Lokal të Veprimit për Rininë (PLVR)** dhe ka për qëllim të sigurojë që çdo aktivitet të realizohet me sukses dhe sipas objektivave të përcaktuara.

Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve janë komponentë thelbësorë për të përmirësuar efektivitetin e vetëqeverisjes vendore. Ky proces ofron informacion të rëndësishëm për zbatimin e objektivave dhe programeve të parashikuara, duke mundësuar që Bashkia Roskovec të përmirësojë praktikën e saj përmes analizës së zbatimit. Duke u bazuar në këtë informacion, do të mund të rritet efikasiteti i politikave dhe aktiviteteve të ndërmarra, duke bërë që përparësitë e rinisë të realizohen në mënyrë të qëndrueshme.

Një sistem i suksesshëm monitorimi dhe vlerësimi kërkon përpjekje të vazhdueshme, ekspertizë dhe aftësi të larta menaxheriale. Ky proces është thelbësor për shmangien e devijimeve nga objektivat e **PLVR 2025-2027** dhe për të siguruar që zbatimi të realizohet pa pengesa. Për të garantuar një monitorim dhe raportim cilësor dhe të dobishëm, është e nevojshme që të përcaktohen disa elemente kyçe:

1. Procesi i qartë i raportimit dhe monitorimit, i cili duhet të përcaktojë përgjegjësitë dhe kalendarin e veprimeve, si dhe të mundësojë një ndjekje të vazhdueshme të progresit të aktiviteteve.
2. Modelet dhe instrumentet e monitorimit, të cilat janë të nevojshme për të siguruar një rrjet të qartë komunikimi ndërmjet strukturave përkatëse dhe për të mbështetur paraqitjen e informacionit në mënyrë të thjeshtë dhe të organizuar.
3. Kapaciteti i strukturave përgjegjëse duhet të jetë i fortë dhe i përmirësuar vazhdimisht përmes trajnimeve dhe praktikës, që të mundësojë një menaxhim efikas dhe ndjekje të suksesshme të aktiviteteve.

Sistemi i Monitorimit dhe Vlerësimit do të përbëhet nga dy nivele të rëndësishme:

1. **Niveli i parë** lidhet me monitorimin e aktiviteteve dhe arritjen e indikatorëve të përcaktuar në dokumentin strategjik. Ky proces do të realizohet nga strukturat përgjegjëse brenda Bashkisë Roskovec, të cilat do të dërgojnë raportet e monitorimit

te struktura të tjera përgjegjëse për vlerësimin dhe jetësimin e prioriteteve të planit. Periodiciteti i monitorimit do të përcaktohet sipas specifikave të secilit projekt.

2. **Niveli i dytë** është vlerësimi i përmbushjes së objektivave dhe rezultateve të pritshme. Ky vlerësim do të realizohet çdo fund viti, duke analizuar raportet e monitorimit dhe duke vlerësuar masën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara. Në raste të veçanta, do të bëhen edhe sugjerime për ndryshime në projekte, afate, fonde dhe aktivitete për të siguruar arritjen e rezultateve të pritura.

Në fund, procesi i monitorimit do të bazuar në procedurat administrative të përgatitura për të siguruar raportet mbi zbatimin e projekteve dhe për të ndihmuar Bashkinë Roskovec të mbajë një sistem të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të monitorimit dhe vlerësimit të Planit Lokal të Veprimit për Rininë.

**MIRATOI
KRYETAR
Majlinda Bufi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR**

Maksim Goga

